



## **FTESË PËR OFERTË**

**Lënda:** Realizimi i printimeve të “Videove satirike dhe gazmore (Kamera e fshehtë)”

**Projekti:** 3xMirë, Për Ty, Për Mjedisin, Për Komunitetin – Bashkia Kamëz

### **Përshkrimi i Projektit:**

Projekti “3Xmirë” Për ty, për Mjedisin për Komunitetin - Bashkia Kamëz” vjen si një përgjigje e ambicies së bashkisë për t’a transformuar nga një bashki me densitetin më të madh urban në Shqipëri për nga sipërfaqja, në një bashki me zona të ndryshme të gjelbëruara por edhe me një Park të veçantë si ai i “Liqeni i Paskuqanit” në të cilën mund të organizohen aktivitete të ndryshme sportive për të gjallëruar tek qytetarët në mbrojtjen e mjedisit dhe jetesën e shëndetshme. Projekti me një afat 6 mujor, synon edukimin mjedisor, bashkëveprimi me autoritetet vendore për të ofruar një jetë të shëndetshme, me mjedise urbane më të pastra e të gjelbëruara dhe diversifikimin e aktiviteteve të sportit dhe rikreacionit në Parkun urban “Liqeni i Paskuqanit”.

“North Green Association” është një organizatë jo-fitimprurëse cila ka mission të ofrojë mundësi në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe të inkurajojë partneritetin për kujdesin dhe mbrojtjen të mjedisit duke frymëzuar me ide, aktivitete innovative, si edhe duke informuar, bashkëpunuar me të rinjtë, me profesorë, me institucionet arsimore, qendrore, lokale, aktivitete private organizata kombëtare/ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në përmirësimin e cilësisë së jetës pa kompromentuar atë të brezave të ardhshëm.

### **Përshkrimi i shërbimit që kërkohet:**

North Green Association në kuadër të projektit “3Xmirë” Për ty, për Mjedisin për Komunitetin - Bashkia Kamëz”, është e interesuar të kontaktojë shërbimin e realizimit e kamerave të fshehta gazmore (sensibilizuese dhe satirike) për ndotjen e mjedisit si pjesë e aktiviteteve të këtij projekti.

